

STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ FETAU COMPANY “ Sh.P.K

Sot , me date 02 / 06 / 2020 , ne qytetin e Beratit , personi i meposhtem :

- Z.Adrian Fetau , shtetas shqiptar, i biri i Ylmi, i datelindjes 20 / 02 / 1981 , i lindur ne Ngjeqar dhe banues ne Ciflik, Berat , mbajtes I leternjoftimit Nr.034764767 me Nr.personal identifikimi I10220002Q , madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar.

krijon shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar “ Fetau Company “ , ne perputhje me :

- * Ligjin Nr.9901 date 14/04/2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”I ndryshuar.
- * Ligjin Nr.9723 date 03/05/2007 “Per Qendren Kombetare te Biznesit”
- * Kodin Doganor, Legjislacionin Tatimor, Fiskal, Bankar.

gjithashtu themeluesi miraton Statutin e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar “ Fetau Company “ , me permbajtje si vijon.

Neni 1
Emertimi

Shoqeria me Pergjegjesi te kufizuar , me Ortak Z. Adrian Fetau, do te emertohet “ Fetau Company “ Sh.p.k. Ky emertim do te jete i stampuar ne vulen e saj dhe me te cilin do te paraqitet ne cdo dokumentacion me te tretet.

Ne te gjitha aktet dhe dokumentat qe do te dalin nga shoqeria, emertimi i saj do te shoqerohet edhe me inicialet “Sh.p.k” , shuma e Kapitali Themeltar si dhe Selia Qendrore.

Neni 2 Forma

“ Fetau Company “ Sh.p.k është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar dhe është Person Juridik . Ajo e fiton të drejtën si Person Juridik , nga data e aplikimit dhe miratimit në Qendren Kombëtare të Biznesit, ndërsa ushtrimin e veprimtarisë tregtare të saj e fillon menjëherë pas marrjes së Certifikatës NIPT (NUIS) pranë QKB.

Neni 3 Selia

Selia qendrore e shoqërisë “ Fetau Company “ Sh.p.k , ndodhet në qytetin e Beratit, Fshati Ciflik lagjia”Musagajas”, nr.pasurie 702/7 , Zona kadastrale Nr.1405

Me Vendim të Asamblesë së Ortakëve , ajo mund të themelojë,transferojë dhe mbylli (në rast se janë celur) dege, filiale,magazine e seli të tjera sekondare, brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 4 Kohezgjatja

Kohezgjatja e veprimtarisë së shoqërisë “ Fetau Company” Shpk do të jetë **PA AFAT**. Shoqëria mund të priset përpara këtij afati me vendim të Asamblesë së Ortakëve

Neni 5 Objekti

Objekti I aktivitetit të shoqërisë do të jetë:

Import-eksport, prodhim, furnizim, montim dhe tregtim I serave diellore dhe sistemeve të tyre të ujitjes, ushqimit, hijezimit sipas teknologjive përkatëse.

Objekti i aktivitetit të shoqërisë mund të ndryshohet dhe/ose zgjerohet me Vendim të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe këtë statut.

Neni 6

Kapitali Themeltar

Kapitali Themeltar i shoqerise "Fetau Company " Shpk eshte 1,600,000 (Nje milion e gjashteqinde mije) Leke. Kapitali I shoqerise ndahet ne nje numer kuotash ne raport me kontributin e dhene nga cdo ortak ne shoqeri, ku cdo ortak zoteron nje kuote te vetme. Kuota keto , te shlyera teresisht nga ortaku dhe e ndare si me poshte:

- Z. Adrian Fetau , 1 kuote me perqindje ne pjesemarrje 100 % , me vlere 1,600,000 leke, qe perfaqeson 100 % te kapitalit te shoqerise.

Neni 7

Kontributet dhe kuotat

- Z. Adrian Fetau , shtetas shqiptar, i lindur ne Ngjeqar dhe banues ne Ciflik Berat , mbajtes I leternjofimit Nr.034764767 me Nr.personal identifikimi I10220002Q , do te ofroj nje kontribut ne para te barabarte me 100 % te kapitalit fillestar , prej 1,600,000 (Nje milion e gjashteqinde mije) leke.

Kontributi I ortakut te vetem, si me siper,do te jete ne para dhe do depozitohet ne nje llogari bankare te hapur ne emer te shoqerise "Fetau Company" Shpk, brenda 8 diteve

Sipas kontributeve te mesiperme:

- Z. Adrian Fetau , do te mbaje 1 kuote me vlere 1,600,000 leke.

Neni 8

Zmadhimi i kapitalit themeltar

- 1- Kapitali themeltar mund te rritet pa kufi ne cdo moment, nje ose disa here, me Vendim te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise, shoqeruar me raportin e ekspertit te autorizuar.

- 2- Ne rast te rritjes se kapitalit te shoqerise , kuotat e ortakeve te Shoqerise rriten sipas shumave te percaktuara ne Vendimin e Asamblese se Ortakeve.
- 3- Kapitali themeltar mund te zmadhohet me kontribut ne para ose ne natyre.
- 4- Zmadhimi I kapitalit duhet te njoftohet prane Qendres Kombetare te Biznesit dhe behet efektiv ne daten e rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit

Neni 9 Zvogelimi i kapitalit themeltar

- 1- Kapitali themeltar I shoqerise mund te zvogelohet vetem me nje vendim te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise
- 2- Zvogelimi I kapitalit perballohet nga secili prej ortakeve sipas shumave te percaktuara ne Vendimin e Asamblese
- 3- Kapitali Themeltar ,per cfaredo shkak, nuk mund te zvogelohet ne nje shume me te vogel se minimum ligjor.

Neni 10 Transferimi i kapitalit themeltar

Kuotat e kapitalit te nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre, mund te fitohen apo te kalohen nepermjet :

- a) Kontributi ne kapitalin e shoqerise
- b) Shit-blerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter te parashikimit ne ligj.

Ne rastin e kalimit me kontrate , kontata duhet te behet me shkrim.

Personi qe e kalon kuoten dhe personi qe e perfiton ate, pergjigjen ne menyre solidare, ndaj shoqerise per kalimin e saj ne Qendren Kombetare te Biznesit , sipas nenit Nr.43 te Ligjit Nr.9723 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit". Rregjistrimi I kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.

Pjeset e Kapitalit Themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

Neni 11
Asambleja e Ortakeve dhe kompetencat e saj

- 1- Asambleja e Ortakeve eshte I vetmi organ vendimmarres I shoqerise
- 2- Vendimet e Asamblese se Zakonshme dhe te jashtezakonshme, per te cilat kerkohet nje shumice e thjeshte ose e kualifikuar, jane te vlefshme vetem nese jane te pranishem ortaket qe perfaqesojne me shume se 51% te te gjithe Kapitalit Themeltar.
- 3- Vendimet qe merr kjo asamble me shumice votash, jane te detyrueshme per ortaket qe mungojne ose qe kane mendim te kundert. Ortaket kane te drejten e ankimit ,te cilin mund ta ushtrojne ne rastet, kohen dhe format qe lejon ligji.

Neni 12
E drejta e pjesemarrjes dhe votes

- 1- Cdo ortak ka te drejten e pjesemarrjes ne Asamble, te paraqes mendimin e tij dhe te jap vota ne baze te perqindjes ne pjesmarrje, qe perfaqeson kuota e tij ne kapitalin e shoqerise.
- 2- Cdo ortak ka te drejte te perfaqesohet edhe nga nje person jo-ortak,I pajisur me prokure me shkrim , me ane te se ciles mund te jap voten e tij.
- 3- Ortaku nuk mund te leshoje prokure per votim per nje pjese te kuotave te kapitalit qe zoteron, neqoftese voton personalisht per pjesen e mbetur te kuotave.

Neni 13
Asambleja e Ortakeve dhe thirrja e saj

- 1- Asambleja e Ortakeve thirret te pakten njehere ne vit, brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar per miratimin e bilancit, ta raportit te administratorit , te raportit te ekspertit si dhe te inventarit.
- 2- Asambleja mund te thirret ne cdo moment nga nje prej administratoreve ,ose nga nje/disa ortakeve qe perfaqesojne me shume se 10% te kapitalit themeltar.
- 3- Asambleja duhet te thirret nepermjet njoftimit me leter rekomande qe duhet tu dergohet ortakeve, ne adresat e rregjistruara ne librin e ortakeve dhe te ekspertit kontabel te autorizuar (nese eshte emeruar), te pakten 30 dite perpara mbledhjes se Asamblese. Ne kete leter do te njoftohet ceshtja qe do te trajtohet, vendi, data dhe ora e mbledhjes

- 4- Asambleja mund te thirret edhe jashte selise se shoqerise,ne Shqiperi.
- 5- Asambleja do te thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve te njoftimit, ne rast se jane te pranishem te gjithë ortakët qe perfaqesojne te tere kapitalin themeltar.
- 6- Asambleja percakton politikat tregtare dhe ekonomike te shoqerise dhe mbikqyr zbtatimin e tyre nga administrator.
- 7- Emeron dhe shkarkon administratorin.
- 8- Emeron dhe shkarkon ekspertin kontabel dhe/ose likujduesin e shoqerise.
- 9- Miraton pasqyrat financiare dhe raportet e ecurise se veprimtarise.
- 10- Merr vendimin per shperndarjen e fitimeve,dividenteve.
- 11- Merr vendim per zmadhimin dhe zvogelimin e kaitalit.
- 12- Merr vendim per ristrukturimin e shoqerise ose prishjes se saj.
- 13-
- 14- Asambleja vendos per ndryshimet ne Statut dhe Akt themelimi ,me voten e ortakeve qe perfaqesojne $\frac{3}{4}$ e ortakeve te pranishem.
- 15- Cdo Asamble drejtohet nga administratori ose,ne rast te mungeses se tij, nga ortaku qe zoteron pergjindjen me te madhe te kapitalit te shoqerise.
- 16- Vendimet e Asamblese duhet te nenshkruhet nga te gjithë Ortaket.

Neni 14 **Administrimi**

- 1- Shoqeria administrohet nga te pakten nje administrator dhe maksimumi tre administrator, te cilet mund te jene dhe jo ortak dhe emerohen e shkarkohen nga Asambleja e Ortakeve.
- 2- Administratori/et qendrojnë ne postin e tyre per nje periudhe maksimumi 5 vite financiare, me mundesine per tu rizgjedhur.
- 3- Administratori eshte perfaqesuesi ligjor I shoqerise. Ka te gjitha kompetencat per te vepruar me te tretet ne interest e shoqerise. Ka te drejten te emerohet perfaqesues te posacem per akte te vecanta ose per kategori aktesh.
- 4- Administratori I pare I shoqerise eshte Z.Adrian Fetau, shtetas shqiptar, i lindur ne Ngjeqar dhe banues ne Ciflik Berat, mbajtes I leternjoftimit Nr.034764767 me Nr.personal identifikimi I10220002Q.
- 5- Me autorizim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, me tre te katertat e votave te saj, administratori/ja mund te mbaj pozicion drejtues ne nje shoqeri tjeter e cila ushtron veprimtarine ne te njejtin sektor ekonomik, ose mund te mbaj statusin e tregtarit per te ushtruar veprimtari ne kete sector ekonomik.

Neni 15

Kompetencat e administratorit

Te kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise , duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga asambleja e pergjithshme.

Te perfaqesojne shoqerine tregtare.

Te kryejne rregjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise , si parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Rregjistrimit .

Te pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, si dhe raportin per ecurine e veprimtarise dhe sebashku me propozimin per shperndarjen e fitimit, ti paraqese keto dokumenta perpara asamblese se pergjithshme per miratim.

Te kryejne te gjitha detyrat e tjera qe i sjell pozicioni dhe percaktuara ne statut, duke zbatuar ligjet ne fuqi.

Te jape dhe kerkoj kredi ne emer te shoqerise.

Neni 16

Pergjegjesite dhe detyrimet e administratorit

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise dhe te treteve , per shkelje te ligjeve, statutit dhe faje te kryera gjate administrimit.

Duhet te ushtroje kompetencat e tij ne te mire te interesit te shoqerise ne teresi.

Te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, te interesave personale me ato te shoqerise.

Nese administratori vepron ne kundersizhti me detyrat sipas pikave te ketij neni dhe me larte, eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes.

Neni 17

Eksperti Kontabel

Ne raste se kerkohet nga ligji,apo vendoset nga Asambleja e Ortakeve, kontrolli I bilanceve dhe librave kontabel te shoqerise, mund ti besohet nje Eksperti Kontabel.

Eksperti kontabel I autorizuar mund te shkarkohet sipas menyres se parashikuar ne legjislacionin ne fuqi.

Neni 18

Viti financiar dhe bilanci vjetor

Viti financiar fillon me 1-Janar dhe mbaron me 31-Dhjetor te secilit vit.
Viti I pare financiar fillon me daten e rregjistrimit te shoqerise ne Rregjistrin tregetar dhe mbaron me 31-Dhjetor te po atij viti.
Bilanci vjetor, inventari, raportet e administratorit dhe ekspertit kontabel te autorizuar miratohen nga Asambleja e Ortakeve , me shumicen sipas Ligjit Nr.9901 date 14/04/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" I ndryshuar.
Miratimi I dokumentave si me siper, qe lidhen me vitin financiar, duhet te behet brenda 6-muajsh nga fundi i vitit financiar.

Neni 19

Fitimet dhe shperndarja

Fitimet neto qe rezultojne nga bilanci vjetor, duke zbritur 5% qe caktohen per rezerven ligjore ,duke zbritur gjithashtu te gjitha shumat qe asambleja vendos ti leri menjane, u shperndahen ortakeve ne perpjestim me kuotat e kapitalit themeltar te zoteruara.

Neni 20

Prishja

Shoqeria mund te priset me perfundimin e afatit te parashikuar ne statut, ose perpara perfundimit ne rastet e parashikuara nga ligji, ose me nje Vendim te Asamblese se Ortakeve me shumicen e kerkuar per ndryshimet ne statut.
Shoqeria nuk priset ne rast te humbjes se zotesise per te vepruar, pazotesise juridike, vdekjes ose falimentimit te ortakeve.

Neni 21

Likuidimi

Ne rast prishje te shoqerise, per cfaredo shkak, do te sjell likuidimin e saj.
Per te administruar kete procedure, asambleja emerone nje ose me shume likuidatore, te cilet kryejne kete detyre ne perputhje me Ligjin ne fuqi.
Likuidatori ka te drejta te plota per te shitur aktivet e shoqerise, per te shlyer kreditoret, mbledhur kredite dhe per te shperndare mbetjen midis ortakeve, ne perpjestim te kuotave te zoteruara ne kapitalin themeltar.

Me perfundimin e procedures se likuidimit ,Asambleja do te vendose mbi bilancin perfundimtar, mbi punen e kryer nga likuiduesi dhe perfundimin e procesit te likuidimit, me shumicen e kerkuar per ndryshimet ne statut.

Neni 22 Transformimi

Shoqeria mund te shnderrohet ne shoqeri kolektive ose ne shoqeri komandite vetem me miratimin unanim te ortakeve, ndersa mund te shnderrohet ne Shoqeri Anonime me miratimin e shumices se ortakeve qe mbajne me shume se $\frac{3}{4}$ e kapitalit themeltar.

Neni 23 Zgjidhja e mosmarreshjeve

Te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin me interpretimin e/ose zbatimin e ketij statuti dhe aktit te themelimit, si dhe ato qe mund te lindin gjate funksionimit ose likuidimit midis ortakeve do te zgjidhen ne menyre miqesore dhe do te diskutohen ne menyre te drejte per drejte midis paleve te interesuara.

Ne rast se nuk arrihet nje zgjidhje miqesore te mosmarreshjeve , ato do ti besohen Gjykates se Rrethit Gjyqesor Berat.

Neni 24 Gjuha

Ky statut eshte i perberë ne 4 kopje, ne gjuhen shqipe qe kane vlere te njejte ligjore.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

ADRIAN FETAU

